



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Kuvendi i Komunës
Skupština Opštine

Nr./Br. 02-016/23- 7039/2

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
skupstina.kuvendi@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 31.10.2023. godine



N J O F T I M

MBI TË DREJTËN E PROPOZIMIT TË KANDIDATËVE PËR NDARJEN E „ÇMIMIT TË KOMUNËS SË TUZIT – 15 DHJETORI“ PËR VITIN 2023

Lënda e këtij Njoftimi është ndarja e „Çmimit të Komunës së Tuzit – 15 dhjetori“ për vitin 2023, i cili ndahet për meritat më të larta dhe rezultatet e arritura në punën praktike dhe teorike si dhe veprimtarinë në të gjitha fushat e krijimtarisë njerëzore.

Çmimi ndahet individëve dhe personave juridik nga treva e komunës së Tuzit, por mund tu ndahet edhe individëve të cilët nuk jetojnë në trevën e komunës së Tuzit, nëse arrijtjet e tyre kanë një rëndësi të veçantë për komunën.

Çmimi ndahet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- që vepra të përfaqësojë arritje të rëndësishme në një fushë të veçantë dhe zbatimi i saj paraqet kontribut në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, gjegjësisht nëse rezultatet e realizuara të punës kanë vlerë të jashtëzakonshme;
- që vepra, gjegjësisht rezultatet e punës, në bazë të publikimit apo në mënyrë tjetër i kanë qenë të njohura opinionit deri më 01. nëntor 2023;
- që vepra të jetë tematikisht e lidhur me trevën e komunës së Tuzit, gjegjësisht të ketë një rëndësi të veçantë për komunën e Tuzit ose nëse rezultatet e punës janë realizuar në trevën e komunës.

Të drejtën e propozimit të kandidatit për Çmim kanë shoqëritë afariste, shërbimet publike, partitë politike, organizatat joqeveritare, shoqatat sportive dhe të tjera, grupe qytetarësh dhe individët, me vendbanim, gjegjësisht me seli në Komunën e Tuzit.

Propozimet dorëzohen në formë të shkruar, ku duhet shënuar se për cilën vepër dhe rezultate të arritura kandidati propozohet për ndarjen e „Çmimit të Komunës së Tuzit – 15 dhjetori“, së bashku me arsyetimin dhe dokumentacionin në bazë të cilit do të çmohet vlera e rezultateve të arritura.

Propozimet dorëzohen Kuvendit të komunës së Tuzit, drejtpërsëdrejti në arkivin e Komunës së Tuzit, Tuzi p.n., me mbishkrimin: **për Jurinë për ndarjen e çmimit të Komunës së Tuzit, më së largëti deri më 25.11.2023.**

JURIA PËR NDARJEN E ÇMIMIT
„15 DHJETORI“ TË KOMUNËS SË TUZIT
Kontakt telefoni: 020/875-167

